



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 07
Prishtinë, më 16.04.2013, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2.

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione**

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdali, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Të ftuar: Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, zv.ministri i Punëve të Brendshme, z. Ismi Zeka dhe Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi.

Pjesëmarrës të tjerë: Resmi Hoxha-Komisar i Burgjeve, Florie Kryeziu-UNICEF; Isa Hasani dhe Faton Morina-IAP, Elita Vokshi dhe Lejla Selimi- OSBE, Visar Bivolaku-EUO/EUSK, Etleva Skonja-Kosova Sot, Xhavit Nura- Koha Ditore, Xhemajl Berisha-Institutit për Demokraci, Blerta Qehaja-PROGRAEK-RRJETI dhe Ukë Gashi-ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi Suzan Novobërdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25 mars 2013;

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë, ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuqi, ministri i Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi;
4. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 25 mars 2013

Komisioni vendosi që procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25 mars 2013 të miratohet në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë

Kryetarja- Fillimisht përshëndeti të pranishmit, si dhe ministrin e Drejtësisë, z. Hajredin Kuqi, që i është përgjigjur ftesës së Komisionit. Ajo tha, se Komisioni ynë ka disa rekomandime të raportit të Avokatit të Popullit dhe për t'u informuar me në detaje se çka është ndërmarrë nga kjo ministri lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve do të informohemi nga ministri, z. Hajredin Kuqi.

Hajredin Kuqi - Ministër i Ministrisë së Drejtësisë, përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit duke shtuar se sa i përket rekomandimeve në raportin e Avokatit të Popullit, prej se jam ministër i Drejtësisë jam përpjekur, që sa i përket Shërbimit Korrektues, respektivisht qendra e paraburgimit, të paraburgosurit duhet t'i kenë të drejtat edhe lirit e tyre, qasja dhe bashkëpunimi me Avokatin e Popullit ka qenë e tërësishme, kam angazhuar edhe organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, në veçanti këshillin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, të cilët kanë qasje në qendra të paraburgimit, dhe qendër korrektuese 24 orë. Në këtë drejtim kam themeluar edhe inspektoratin e shërbimit korrektues, në shërbim që edhe puna e gardianëve, edhe e personelit tjetër të jetë e mbikëqyrur.

Sa i përket organizimit të seminareve dhe trajnimeve për stafin, në këtë drejtim kemi qenë të kujdesshëm dhe bëjmë përpjekje, që jo vetëm stafi që punon, por edhe të burgosurit të kenë mundësinë e qasjes, në edukim të vazhdueshëm, në veçanti kemi dhënë mundësinë për ata që janë te moshës së mitur të vazhdojnë shkollimin e tyre.

Ai tha se si ministër ka bërë disa ndryshime, e para që ata të mitur në burgun e Lipjanit të shkojnë në shkolla publike dhe nuk shkojnë me veshje tjetër nga nxënësit tjerë, dhe gardianët të cilët i përcjellin fëmijët për në shkollë i përcjellin me rroba civile, kam marrë vendim bashkë me ministrin e Arsimit që në diploma që janë të lëshuara nga qendrat korrektuese, por diploma që janë lëshua nga një shkollë e mesme në mënyrë që të kenë mundësi që të rehabilitohen dhe mos të kenë stigmatizim tërë jetën e tyre.

Sa i përket njoftimit të paraburgosurve dhe të burgosurve me të drejtat dhe obligimet e tyre në mënyrën e parashtrimit të ankesës, me kodin e ri të procedurës penale e kemi qartësuar edhe më mirë, në veçanti obligimet e policisë ndaj të arrestuarit. Çdo qytetar në momentin arrestimit të tij duhet të ketë të drejtën për të pasur avokat pa pagesë, sipas kodit i cili garantohej që nga momentet e para të procedurës.

Kemi marrë masa për trajtimin e barabartë të të dënuarve në kuptimin e beneficioneve dhe privilegjeve, kemi harmonizuar ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale që është amendamentuar dhe shumë shpejt hyn në fuqi.

Në qendrat e paraburgimit tha se janë 1847 persona, që është një mbipopullim, po mundohemi ta bëjmë më të mirën, si me shkollim, me ushqim e të tjera që ata persona t'ia kthejmë shoqërisë si qytetarë të barabartë dhe jo t'i mbajmë të izoluar dhe pastaj të jenë recidivist në shoqëri.

Rita Hajzeraj- Bëri pyetje sa i përket marrjes së lejes për vizita, sepse ato leje merren në Prishtinë e për qytetarët e tjerë është shqetësim, sa u përket prokurorëve që caktohen për raste të paraburgimit shumica e tyre bëjnë zvarritjen e lëndëve, a është neglizhencë e autoriteteve përkatëse.

Hajredin Kuçi- Tha se leja për vizite është e paraparë shume saktë me ligj, sa i përket punës së prokurorëve është punë jashtë domenit të ministrisë.

Kymete Bajraktari- Tha se u përmend se kategorizimi i personave të dënuar do të bëhet më mirë kur të bëhet burgu për siguri të lartë dhe për personat e mbrojtur. Më intereson se si po bëhet momentalisht kategorizimi i të burgosurve? Jemi në dijeni se bëhet transformimi i të burgosurve prej një qendre në qendrën tjetër kush e bënë transformimin dhe kush e jep këtë propozim?

Hajredin Kuçi- Tha se kategorizimi i të burgosurve ndodh edhe tani, kategorizimi i parë bëhet nga gjykata, burgu për dëshmitar të mbrojtur ka hyrë në funksion më 2011. Ne kemi kapacitete për 60 femra dhe 60 meshkuj, janë kushtet e nivelit më të lartë që janë vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian. Burgu për siguri të lartë do të fillojë të funksionojë në shtator të këtij viti dhe lehtëson kategorizimin e të burgosurve.

Resmi Hoxha- Tha se transferimi i të burgosurve bëhet për dy arsye, për shkak të sigurisë dhe për çështje sociale, këto janë dy elementet kryesore për të cilat bëhet transferimi.

Biserka Kostiq- Bëri pyetje kryesisht për marrjen e lejeve për vizita, cilat janë kriteret dhe kush mund t'i vizitojë të burgosurit dhe të gjykuarit e caktuar, sepse dijë se pjesëtarët e bashkësisë serbe nuk mund t'i vizitojë askush tjetër përveç familjareve të ngushtë, dhe me intereson të dijë kush dhe si caktohen dhe kur vizitorët për të burgosurit, sepse familjarët më të gjerë nuk kanë të drejtë vizite?

Hajredin Kuçi- Tha se kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe nëse ndryshohet ligji ndryshojmë edhe ne. Në fazën e paraburgimit merr vendim vetëm gjyqtari, në fazat e

tjera, po ashtu, është e parapamë me ligj, nuk kemi trajtim në atë mënyrë se a është serb ose shqiptar, i respektojmë të gjithë njëjtë.

Biserka Kostic- Tha se pajtohet, por te një i burgosur në Prishtinë askush nuk mund të vijë në vizitë për veç bashkëshortes, nënës dhe babait, nuk dijë kush i cakton dhe si?

Resmi Hoxha- Tha se ka raste kur i paraburgosuri, apo i burgosuri deklarohen se kush dëshiron që atë ta vizitojë, nëse është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm. Ne krijojmë kartonin e vizitorëve, të cilët evidentojnë të gjithë të afërmit e familjes se kush dëshiron të jetë në atë listë.

Albana Gashi- Tha se sa i përket kategorizimit të burgosurve në vizitën e fundit që Komisioni ka bërë në burgun e Dubravës, aty kemi parë një person me të meta mendore, gjë që paraqet rrezik për të burgosurit e tjerë, dhe pyeti se a konsiderohet i nevojshëm lidhja e një memorandumit mirëkuptimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, sepse ka shumë të burgosur që për shkak të rrethanave janë detyruar të ndërpresin arsimimin universitar? Kemi një rast kur një i burgosur i vazhdon studimet në një universitet privat, por nuk kemi raste të tjera. A shihet e nevojshme nënshkrimi i një memorandumit të tillë në mes këtyre dy ministrive?

Hajredin Kuçi- Tha se kemi bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, kemi qenë tolerant ndaj arsimit të obligueshëm dhe arsimit të mesëm, për çështjen e arsimimit të lartë vendos drejtoria në qendrat e shërbimit korrektues se kujt i jepet kjo e drejtë dhe si?

Kurtan Kajtazi- Tha se është një raport i Avokatit të Popullit i vitit 2011, tani jemi në vitin 2013, në bazë të raportit të Ministrisë së Drejtësisë po shihet që shumica e këtyre rekomandimeve janë plotësuar, nuk është çdo gjë perfektë, po bëhet një punë për të përmirësuar gjendjen dhe me funksionalizim e burgut për siguri të lartë situata do të ndryshoj për së miri.

Hajredin Kuçi- Tha se 28 euro i kushton buxhetit të Kosovës një i burgosur brenda 24 orëve, kemi paraparë me kodet e reja dënimet alternative, që fatkeqësisht ende nuk po implementohen. I ftoj gjykatësit prokurorët dhe avokatët e të akuzuarve që të kërkojnë dënime alternative, sepse këto dënime ndihmojnë që mos t'i kushtojë buxhetit të vendit, që të jenë në rrethin familjar të punës dhe nuk bëhet mbipopullimi i burgjeve, janë 200 persona që kishin mundur me qenë me dënim alternativ.

Kryetarja- Falënderoj ministrin e Drejtësisë për informacionet dhe përgjigjet e ofruara para Komisionit.

Ajo tha se tani kemi prezent edhe zv. ministrin e Punëve të Brendshme z. Ismi Zeka, që të raportojë lidhur me rekomandimet e Avokatit të Popullit, ku paraqiten edhe disa shqetësime, për përdorim të forcës së tepruar, apo tejkalimit të kompetencave të detyrës zyrtare nga ana e policëve gjatë marrjes në pyetje të personave të ndaluar. Pastaj për përdorimin e mjeteve piroteknike, dikush po përfiton nga importimi i tyre dhe gjatë përdorimit po krijojnë lëndime të ndryshme të qytetarëve, po bëhet zhurmë dhe ndotje e ajrit. Policia e Kosovës duhet të jetë më azhure në zbulimin e kryerësve të veprave penale

në përgjithësi, ka vjedhje të shumta dhe përkundër dëshmive që kemi, nuk ka ndriçim të rasteve.

Ismi Zeka zv. ministër i Punëve të Brendshme, falënderoj anëtarët e Komisionit për ftesën, dhe tha se sa i përket rekomandimeve të Avokatit të Popullit, lidhur me pyetjet do bëjë përpjekje që të përgjigjem. Policia e Kosovës në vitin 2012 dhe në tremujorin e parë të vitit 2013 ka mbajtur 16 trajnime dhe 12 seminare, ku kanë marrë pjesë 440 pjesëmarrës nga fusha të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Çdo person i arrestuar informohet nga zyrtarë të policisë në dy mënyra, zyrtari policor informon gojariisht personin e arrestuar për të drejtat e tij me një herë pas arrestimit dhe informim me shkrim për të drejtat e tij, duke i lënë në dispozicion formularin dhe njoftimin me shkrim për të drejtat që i takojnë.

Personi i ndaluar informohet për arsyen e arrestimit, informohet se mund të mos përgjigjet në pyetje, përveç dhënies së identitetit, se mund të ketë ndihmën e përkthyesit nëse nuk e kupton gjuhën, mund të ketë ndihmën e avokatit mbrojtës, mund të lajmërojë ndonjë anëtare të familjes dhe i afrohet trajtim mjekësor.

Sipas ligjit të policisë dhe procedurave të brendshme, zyrtarët policor bëjnë edhe kategorizimin e të ndaluarve, ata të ndaluar nuk mbahen së bashku me të burgosurit, personat e paraburgosur, me persona të gjinisë së kundërt dhe me persona të mitur.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë ndihmesë për neve dhe po mundohemi të bëjmë respektimin e tyre.

Ai tha se sa i përket tejkalimit të forcës, tha se ka masa, është inspektorati policor që merret me masa të tilla, çdo tejkalim i forcës nga ana e policisë për këtë merren masa ndëshkuese nga ana e inspektoratit policor, dhe për këtë ka raste kur janë suspenduar policet apo masa tjera në përputhje me ligjin.

Sa i përket vjedhjeve, policia e kryen punën e vet deri te prokuroria, pastaj prokuroria duhet të merret me lëndën, sepse është punë vargore mes policisë dhe prokurorisë. Me kalimin kohës besoj se do të ketë përmirësime edhe sa i përket zbulimit dhe kapjes së personave që bëjnë vjedhje.

Kryetarja- Lidhur me vjedhjet që po bëhen, tha se numri i vjedhjeve nuk është në rënie por vetëm në rritje, duhet me i kushtuar rëndësi pse po vjen deri te kjo? Po kapet hajni, por asgjë nuk po kthehet prej gjërave që janë vjedhur, nuk dihet se çfarë procedure është ndërmarrë me atë person që ka kryer vjedhje, me asgjë nuk njoftohet personi i dëmtuar, dhe çka është më e keqja, kjo dukuri është në rritje e sipër, sa i përket kësaj Policia e Kosovës duhet të jetë më efikase.

Sami Kurteshi, Avokat i Popullit- Falënderoj anëtarët e Komisionit për ftesën, tha se është shqetësuese zbulueshmëria e kryerësve të veprave penale nga ana e policisë, prej të gjitha rasteve nga 11644 kallëzime të kryerësve të panjohur, të pranuar në vitin 2011 janë zbuluar vetëm 2.6% të rasteve të kryerësve të veprave penale. Ndërsa 3990 ose 34.2 % të lëndëve janë hedhur poshtë, sepse janë parashkruar. Neve na shqetëson fakti i mos përgjigjes në rekomandimet tona nga ana e ministrisë, dhe nuk marrim asnjë përgjigjeje nga ministria, por kemi bashkëpunim të mirë me policinë.

Albana Gashi- Tha se ka ankesa prej shumë qytetarëve se pasi të njoftohet policia për vjedhje, me orë të tëra policia nuk vjen në vendin e ngjarjes, vonesat zgjasin 5-6 orë e edhe më shumë, a ka mungesë të policëve, të makinave, apo ku është problemi i vonesës, edhe kur vjen policia në vendin e ngjarjes, vinë policë të thjeshtë me një mjet fotografik (aparati) dhe nuk vinë njësitë e forenzikës?

Unë, po ashtu, dua ta shpreh brengjen time sa i përket raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me protestën e 14 dhe 22 janarit, i cili raport ka kaluar pothuajse një vit e gjysmë dhe nuk është shqyrtuar nga Komisioni, por problem në identifikimin e policëve të cilit kanë përdorur dhunë të tepruar ka qenë edhe numri identifikues, shumë policë të njësisë speciale kanë qenë të dhunshëm ndaj qytetarëve, dhe qytetari nuk e ka mundësinë të ngritë padi, sepse nuk e ka numrin e tij të identifikimit, janë të maskuar dhe nuk ka mundësi identifikimi. Dhe për numrin identifikues janë bërë rekomandime edhe nga Avokati i Popullit dhe a është marrë parasysh ky rekomandim?

Ajo tha se kemi pasur rastin kur vetë inspektori i policisë ka asistuar Policinë e Kosovës dhe njësinë speciale në arrestimin e qytetarëve. E detyrë e inspektorit është ta vëzhgojë punën e policisë. Çka keni ndërmarrë ju në këto raste si Ministri e Punëve të Brendshme?

Ismi Zeka- Tha se kemi një polici që është trajnuar dhe ende vazhdon të trajnohet, nuk është e përkryer, kemi vjedhje, policia e bën punën e vet, ende kemi mungesë të numrit të policeve për me mundur me pasur efikasitet edhe më të madh, së pari rastin e marrin policia e thjeshtë, pastaj njoftohen organet e tjera të policisë se nuk dihet për çka është fjala, e nëse është e nevojshme, në vendngjarje dalin edhe njësitë e forenzikës.

Sa i përket njësisë speciale të policisë, ne jemi në dijeni dhe jemi në proces edhe për protestën. E dimë si ka ndodhur, qytetarët duhet ta dinë se policia janë për ta mbrojtur rendin dhe ligjin, dhe nëse ka tejkalim të forcës me këtë merret inspektorati policor.

Ai tha se sa u përket rekomandimeve do të mundohemi ta bëjmë më të mirën duke pasur parasysh në atë çka parasheh ligji.

Rita Hajzeraj- Tha se i intereson të dijë ku ka ngecje Policja e Kosovës, ku nuk ka pasur rezultate. Pastaj si ministri t'i merrni rekomandimet si të Avokatit të Popullit, ashtu edhe të Kuvendit, e dimë që nuk mundeni me bërë të pamundshmen, por këto që u thanë janë fakte konkrete që nuk janë thënë vetëm nga Avokati i Popullit, por edhe nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Albana Gashi- Tha se jemi të vetëdijsëm se policia është e popullit, por duhet ta mbrojmë policinë nga urdhrat politike dhe atyre që u binden urdhrave politike, dhe se nuk është mirë të shtrembërohet realiteti.

Kymete Bajraktari- Tha se sa i përket rekomandimit që të standardizohen procedurat e marrjes në pyetje të të akuzuarve nga hetuesi policor dhe prokurorit publik, ngase kjo do të mundësonte modelin unik të veprimeve procedurale dhe do të eliminoheshin qasjet e ndryshme ndaj marrjes në pyetje të të akuzuarve, ky rekomandim është me rëndësi.

Ajo me tej tha se ka një shqetësim ndaj mos sjelljes së raportit për trafikim me qenie njerëzore, e kemi kërkuar para një viti, e kemi përsëritur kërkesën edhe para tre muajve dhe nuk kemi kurrfarë përgjigjeje për këtë raport, nuk është vetëm Avokati i Popullit që

nuk merr përgjigjeje në shkresat e tij nga Ministria e Punëve të Brendshme, por është edhe Komisioni i ynë.

Ismi Zeka- Tha se me vjen keq që nuk jua kanë sjellë raportet. Të gjitha raportet që i keni kërkuar do të sillen, sepse është obligim i ministrisë dhe po u them që për tri ditë do t'i keni ato raporte.

Nëse nuk bëhen intervistat si duhen, sjelljet nuk janë të mira dhe për këtë qytetarët nuk bëjnë ankesë. Mirëpo nëse qytetarët për këtë bëjnë ankesa, për këtë policia nuk është e paprekshme dhe janë mekanizmat që merren menjëherë me këto raste.

Rita Hajzeraj- Tha se kemi raste kur një pjesëtar i njësisë speciale të Policisë së Kosovës, e kërcënon një zyrtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe e pengon në punën e tij, në këtë rast kush merr masa dhe çfarë masa ndërmerren?

Ismi Zeka- Tha se në aspektin procedural, nëse ka informacione policia, duhet të ndërmarrë hapa policia, nëse nuk ka informacione policia duhet personi që atakohet me u ankuar, por kur policia tejkalon normat është inspektorati policor, ai që ndërmerr menjëherë masat, qofshin ato edhe ndëshkimore.

Kymete Bytyçi- Tha se në këtë takim nga zëvendësministri u tha se policia është e trajnuar, a ka qenë i trajnuar polici i cili i ka thënë zyrtarit të Institucionit të Avokatit të Popullit del jashtë.

Ismi Zeka- Duke u ndërlidhur me parafolësen tha të mos merret shembull vetëm zyrtari i Institucionit të Avokatit të Popullit, sepse të gjithë qytetarët duhet të trajtohen njëjtë dhe çfarëdo shkelje që bëhen duhet të merren masa, dhe në raste të tilla edhe ndaj policit, i cili ka bërë një vepër të tillë ndaj përfaqësuesit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe policia duhet me qenë e njëjtë ndaj të gjithë qytetarëve.

Biserka Kostiq- Tha se në një farë mënyre nuk është dhënë asnjë përgjigjeje nga Ministria e Punëve të Brendshme, jeni përgjigjur në mënyrë indirekte, përmendët numër të madh të trajnimeve. Ajo tha se do të ceku një rast konkret sa i përket komunitetit që ajo i përket, Avokati i Popullit ka kaluar mirë vetëm me kërcënime nga polici i Kosovës, sepse anëtarët e njësisë speciale me kontrollet rutinë në terren, kur e ndalin ndonjë qytetarë të komunitetit serb dhe nuk dinë të flasë shqip, nuk trajtohet mirë, madje kërcënohen se nuk guxojnë t' i paraqet rastet, edhe sa u përket vjedhjeve policia nuk po ndërmerr masat e duhura për t' i zgjidhur rastet.

Sami Kurteshi- Tha se kjo çështje është për dënim, nëse ka fakte duhet të dënohen personat për gjërat që ka fakte, nuk ka keqardhje, por duhet veprim, kjo është detyrë e institucioneve.

Rita Hajzeraj- Falënderoj të pranishmit për përgjigjet dhe informacionet e ofruara, tha se tani presim raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe aty do të shihen të arriturat dhe ngecjet e vitit të kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdali